

STATUTI I SHOQATES
SHOQATA SPORTIVE E UNIVERSITETIT " Eqrem Cabej ", GJIROKASTER



Ne mbeshtetje te neneve 39-54 te Ligjit nr. 7850, date 29.07.1994, "Kodi Civil I Republikes se Shqiperise, si dhe te ligjit nr. 8788, date 07.05.2001, " Per Organizatat Jofitimprurese", me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, themeluesit si me poshte :

1. Arjan Pano, I Aleko dhe Angjeliqi, dt. 24.11.1961, lindur e banues ne Gjirokaster, I.Varosh, nr. 29, me nr. pasaporte. BE4112461, nr. personal G11124083C
2. Lorenc Kociu, I Fitim dhe Shaqe, dt. 11.03.1980, Lagjia " 11 Janari ", Rruga Alqi Kondi, Pallati nr. 7, Ap. 4, Gjirokaster, me nr. leternjoftimi 024873150, nr.personal,I00311068R.
3. Elvira Barka, e Grigor dhe Klio, dt. 27.04.1966, banuese ne Gjirokaster, lagjia "18 Shtatori", Kodra e Shtufit, me nr. leternjoftimi 027709004, nr.personal G65427033H.
4. Gezim Sala, I Fetahut dhe Xhevaire, dt. 05.06.1961, banues ne Lagjen 18 Shtatori, Pallati 1017, Gjirokaster, me nr. leternjoftimi 029106552. nr.personal, G10605100K.
5. Bektash Mema, I Brahim dhe Vezire, dt. 23.05.1955, banues ne lagjen " 11 Janari", Rruga Alqi Kondi. Gjirokaster, me nr. leternjoftimi 027773903, nr. personal F50523114W.
6. Gezim Rredhi. I Kaso dhe Vezire, dt. 07.01.1960, banues ne lagjen " 18 Shtatori", Rruga Veli Hashorva, Pallati nr. 17, K.Postar 6001, Gjirokaster. Nr. leternjoftimi, 025260961, nr. Personal, G00107145D.
7. Jani Dine, I Llukan, dhe Vasiko, dt. 03.01.1955, banues ne lagjen " Mustafa Matohiti", Tepelene, me nr. leternjoftimi 025381575, me nr. personal, F50103014V.
8. Aleksander Boboli, I Thanas dhe Kostando, dt. 24.07.1975, banues ne Dervician, Gjirokaster. Me nr. leternjoftimi 025537990, nr. personal, H50724018R.
9. Klaviora Dudumi, e Bujar dhe Rajmonda, dt. 04.07.1984, Lagjia Blloku I Furave, Rruga 7 Krojet, Gjirokaster, me nr. letrnjoftimi 032899510, nr. personal I45704095Q.

Vendosin te hartoje kete statut, mbeshtetur ne parimet e meposhteme :

KREU I

TE DHENAT E SHOQERISE

NENI 1
FORMA E ORGANIZIMIT

- 1.1. Ky person juridik themelohet si Organizate Jofitimprurese (OJF) qe synon realizimin e Veprimtarive ne te mire dhe interest e publikut dhe nuk synon realizimin e fitimeve.

1.2. Kjo OJF eshte e organizuar ne formen e " Shoqates " me anetare.

NENI 2
EMRI I SHOQATES

2.2. Emri I Shoqates eshte " Shoqata Sportive e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster"

NENI 3
SELIA/QENDRA

3.1. Shoqata e ka seline e vet ne Gjirokaster, Prane Rektoratit te Universitetit "Eqrem Çabej", Kodra e Shtufit dhe e zhvillon veprimtarine e vet Brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

3.2. Me miratim te organeve te saj kompetente Shoqata mund te ndryshoje seline, mund te Hape dege dhe filjale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj.

NENI 4
AFATI

4.1. Shoqata do te kete kohezgjatjen e veprimitarise se saj me nje afat te pa caktuar.

KREU II
OBJEKTI

NENI 5
QUELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISE SE SHOQATES

5.1 Shoqata ka si qellim :

- a) - Te promovoja sportin ne jeten universitar te Universitetit te Gjirokastres, nepermjet zhvillimit te aktiviteve sportive qe do te realizohen me mbeshtetjen e UT-se, shoqatave sportive dhe institucioneve te tjera locale dhe kombetare.
- b)- Te inkurajoje, rregulloje dhe nxis pjesemarien e studenteve ne Universitetin e Gjirokastres ne nivele amatore dhe competitive, ne aktivitete social kulturore, sin je factor kyc ne edukimin dhe formimin e tyre.
- c)- Te organizoja veprimitari sportive, ne rang lokal, nacional dhe nderkombetar.
- d)- Te rehabilitoje ambientet sportive.
- e)- Te organizoje skuadra (ekipe) sportive ne disciplina te ndryshme sportive.
- f)- Te zhvilloj sportin universitar ne te gjitha nivelet sportive.
- g)- Te propagandoj te gjitha rezultatet e aritura nga studentet ne disciplina te ndryshme sportive.
- h)- Realizimin e studimeve ne fushen e sportit dhe impakti I tyre ne shoqeri.
- i) - Masivizimi, zhvillimi cilesor dhe organizimi I sportit te Universitetit.

- j) Sigurimi i kushteve për veprimtarinë e të gjitha kategorive të organizuar nga Federatat Sportive.
- k) Avancimi profesional i studenteve, trajnerëve, gjiqtarëve, vëzhguesve dhe akterëve. Ujerë në sportin Universitar.
- m) Sigurimi i ndihmës për organizatat dhe subjektet tjera që kanë për qëllim promovimin e sportit, në përputhje me aktet normative ne fuqi.
- n) Pjesmarrja në veprimtaritë sportive për të gjitha kategoritë dhe gjinitë.
- l) Avancimi i sportit përmes pjesëmarrjes në gara dhe evenimente ndërkombëtare.
- p) Mbështetja e zhvillimit të sportit në gjitha Universitetet ne territorin e Shqipërisë.
- q) Organizimi i kampeve, seminareve, trajnimeve, publikimeve profesionale, etj. Konform dispozitatave ligjore me qëllim avancimin e sportit.
- o) Ndërkombëtarizimi i sportit ne rang Universitetesh dhe sigurimi i pjesëmarrjes së shoqatës në gara dhe turne ndërkombëtare.
- 5.2 Në kuadër te aktivitetit, Shoqata do marrë përsiper procedura ligjore për të plotësuar dhe mbrojtur interesat e saj. Do të mbajë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet shtetërore kur kjo i shërben përbushjes së qëllimit të Shoqatës. Shoqata do të organizojë dhe mbështesë veprimtari si konferanca, seminare që organizohen nga organizata te tjera dhe individë dhe që kanë të njëtin qëllim me atë të Shoqatës.
- 5.3 Shoqata mund të zgjerojë dhe/ose të pakësojë rast pas rasti objektin e veprimtarisë së vet me vendim të organeve kompetente të saj.

NENI 6 NDALIMI I SHPËRNDARJES SË FITIMEVE

- a. Ndalohet çdo formë e shpërndarjes se fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Shoqatës, prej personave që janë subjekt i Statutit, Aktit të Themelimit dhe çdo akti tjetër të Shoqatës, përvèç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontratat e punës dhe kontrata të tjera të ngjashme ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi, përllogari të organizatës joftimprurëse.

KREU III ORGANET E SHOQATËS

NENI 7 ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS

- 7.1 Organe drejtuese të Shoqatës janë:
- (i) Asambleja e Përgjithshme
 - (ii) Presidenti dhe Sekretari i Pergjithshem
- 7.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 8 ANETARET

- 8.1. Asambleja e Pergjithshme e Shoqates perbehet nga te gjithe anetaret e saj, ne te cilen perfshihen anetaret themelues dhe anetare te rinj te ardhur pas themelimit te Shoqates. Anetaret themelues te Asamblese te Pergjitheshme te Shoqates jane :
- | | |
|----------------------|----------------------------------|
| 1. Arjan | Pano, (President) |
| 2. Lorenc | Kociu (Sekretar I Pergjithshem) |
| 3. Elvira | Barka (Anetare) |
| 4. Gezim | Sala (Anetar) |
| 5. Bektash | Mema (Anetar) |
| 6. Gezim | Rredhi (Anetar) |
| 7. Jani | Dine (Anetar) |
| 8. Aleksander Boboli | (Anetar) |
| 9. Klara | Dudumi (Anetare). |
- 8.2. Pervec anetareve themelues te mesiperm, mund te behen anetare me te drejta te plota te Shoqates (Asamblese) pas themelimit te saj, edhe persona te tjere, fizik apo juridik, vendaj apo te huaj, anetaresia (pranimi) e te cileve ne Shoqate I nenshtrohet miratimit te Asamblese ekzistuese sipas rregullave dhe procedurave te percaktuar ne kete Statut.
- Anetar I Shoqerise
- 8.3. Anëtarët e Shoqatës kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamblënë e Përgjithshme dhe në proceset vendimarrëse të saj dhe të njihen e t'ju vendoset në dispozicion çfarëdo lloj dokumentacioni i Shoqatës. Çdo anëtar gjzon të drejtën e një vote në Asamble.
- Anëtarët kanë detyrimin të respektojnë vendimet dhe detyrimet e tyre të përcaktuar nga Asambleja dhe duhet të ndjekin veprimtari që janë në përputhje me interesat e Shoqatës dhe nuk e dëmtojnë atë.
- 8.4. Anëtarët e Asamblesë mund të largohen lirisht nga Shoqata pa asnjë kufizim me anë të një dorëheqje me shkrim drejtuar Shoqatës të paktën 3 muaj përpara.
- 8.5. Anëtarët mund të përjashtohen nga Asambleja me vendim të saj, sipas procedurave të parashikuar në këtë Statut kur anëtarë shkel Statutin, Aktin e Themelimit, rregulloret e brendshme të Shoqatës, abuzon me fondet e dhëna nga Shoqata, tejkalon kompetencat e dhëna nga Statuti, merr pjesë në veprimtari të paligjshme, nuk paguan detyrimet, i ka sjellë dëme Shoqatës nga veprimtaria e tij, si dhe për raste të tjera të gjykuara të arsyeshme nga Asambleja.
- Vota e anëtarit që përjashtohet nuk llogaritet në kourum dhe shumicë.
- 8.6. Anëtarët e Asamblesë qëndrojnë në këtë cilësi deri në momentin që: (i) Shoqata çregistrohet; (ii) anëtarë largohet nga Shoqata me vullnetin e tij; (iii) anëtarë përjashtohet nga Shoqata.

NENI 9 KOMPENTENCAT

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve si më poshtë:
- a) Vendos për ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit;

- b) Miraton Regullat e brendshme të Shoqatës dhe nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së Shoqatës;
 - c) Përcakton dhe miraton fushat, projektet dhe programet e veprimtarisë që do të ndjekë Shoqata;
 - d) Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e qëllimit, veprimtarisë dhe objektivave që Shoqata ka marre përsiper të realizojet;
 - e) Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton bilancet vjetore dhe aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Shoqatës dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm;
 - f) Emëron dhe shkarkon Presidentin e Shoqatës;
 - g) Emëron dhe shkarkon likuiduesin/t;
 - h) Përcakton shpërblimet për personat e përmendura në shkronjat f) dhe g) të këtij neri;
 - i) Krijon komitete të posaçme nëse është e nevojshme me qëllim, realizimin sa më të mirë të veprimtarisë së Shoqatës; Merr vendime për ngritjen e degëve dhe filialeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - j) Vendos për transformimin, ndarjen ose bashkimin e Shoqatës me shoqata të tjera apo për shpërndarjen e saj;
 - k) Vendos mbi shitjen-blerjen e pasurive të paluajtshme dhe disponimin e aktiveve/pasurive të luajtshme të Shoqatës me vlerë më të lartë se 10% e aseteve të saj të rezultuara nga pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;
 - m) Vendos për krijuimin e burimeve financiare shtesë për financimin e programeve dhe projekteve të Shoqatës;
 - n) Vendos mbi pranimin apo mospranimin e anëtarëve e rinj si dhe përjashtimin e anëtarëve nga Asambleja;
 - o) Vendos në lidhje me kuotat që do të derdhin anëtarët;
 - p) Përcakton strukturën e administratës së Shoqatës;
 - q) Në rastin e likuidimit të Shoqatës, përcakton organizatat përfituese të kapitaleve që ka Shoqata;
 - r) Kryen kontolle të parashikuara ose të paparashikuara për të kontrolluar veprimtarinë e Shoqatës si edhe administratën e saj;
 - s) Miraton rregulla proceduriale për mbledhjen e Asamblesë;
 - t) Kryen detyra të tjera të parashikuara nga Statuti dhe ligji.
- 9.2 Lista e kompetencave të Asamblesë nuk është ezauruese. Asambleja mund të marrë në shqyrtim edhe çeshtje të tjera që nuk janë përmendor në këtë Statut kur ato vlerësohen me rëndësi të veçantë për funksionimin normal dhe arritjen e objektivave të Shoqatës.

NENI 10 MBLEDHJA E ASAMBLESË DHE VENDIMMARRJA

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor. Ajo mblidhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur të interesat e Shoqatës, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.
- 10.2 Asambleja thirret nga Presidenti ose nga 1/5 e anëtarëve të saj. Ajo mund të thirret në çfarëdo lloj mënyre që shihet më e përshtatshme dhe/ose efektive nga personi që kryen thirrjen e Asamblesë si, shkresë, postë rekomande, postë elektronike, faks, çdo lloj mjeti të telekomunikacionit, media, telefon, mjete të tjera elektronike, mesazh elektronik, çdo lloj mjeti që përbën zhvillim të fundit teknologji, etj. Mbledhja e Asamblesë mund të

mbahet në selinë e Shoqatës ose në çfarëdo lloj vendi tjetër që shihet e përshtatshme. Njoftimi për mbledhjen kryhet të paktën një ditë përpara ditës së parashikuar për mbledhjen.

Megjithatë modalitetet e më sipërme nuk përbëjnë shkak përvlefshmëri në qoftë se të gjithë anëtarët e Asamblesë janë të pranishëm në mbledhjen përkatëse.

- 10.3 Pjesëmarrja në mbledhje mund të bëhet personalisht ose me anë të një përfaqësuesi të autorizuar. Pjesëmarrja në mbledhje mund të kryhet edhe me mjete të ndryshme komunikimi dhe elektronike të cilat garantojnë identifikimin e anëtarëve që nuk janë të pranishëm fizikisht në mbledhje dhe që mundësojnë transmetim në kohë reale të mbledhjes dhe kryerjen e procesit të votimit pa qenë nevoja e paraqitjes fizikisht të anëtarit apo përfaqësuesit të tij.
- 10.4 Asambleja mblidhet dhe mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të saj. Me përjashtim kur është parashikuar ndryshe në këtë Statut apo në ligj, Asambleja vodos me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Votimi mund të jetë i hapur ose i fshehtë.
- 10.5 Në rast konflikti interesit të ndonjë prej anëtarëve (përfshirë familjarët e tij) në lidhje me vendimin që Asambleja do të marrë, apo në rast se Asambleja do të marrë një vendim që ka lidhje me ndonjërin prej anëtarëve apo familjarëve të tij, vota e anëtarit përkatës nuk llogaritet në kuorum dhe shumicë.
- 10.6 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përban datën, orën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Prosesverbalit nënshkruhet nga Presidenti dhe mbajtësi i procesverbalit. Prosesverbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve.
- 10.7 Mbledha e Asamblesë zgjedh nga anëtarët e vet Presidentin i cili kryeson, organizon dhe kujdeset përmbarëvejtjen e mbledhjes. Në rast se Presidenti mungon, funksionet e tij i kryen Sekretari i Pergjithshem.

PRESIDENTI DHE SEKRETARI I PERGJITHSHEM

NENI 11

- 11.1 Shoqata ka një President i cili përfaqëson ligjërisht Shoqatën tek të tretët. Presidenti i parë është Arjan Pano.
- 11.2 Presidenti është organi më i lartë ekzekutiv i Shoqatës dhe zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 11.3 Presidenti emeron dhe shkarkon Sekretarin e Pergjithshem. Sekretar i Pergjithshem do te Jete z. Lorenc Kociu, per një periudhe 5 vjecare, me te drejte rizgjedhje.

NENI 12 KOMPETENCAT

- 12.1 Presidenti ka këto kompetenca:
- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të Shoqatës, duke zbatuar direktivat, e vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - Emeron dhe shkarkon Sekretarin e Pergjithshem;
 - Është përfaqësuesi ligjor i Shoqatës tek të tretët;

- d) Drejton administratën e Shoqatës dhe merret me organizimin e punës së përditëshme së administratës të Shoqatës;
- e) Ndjek zbatimin e detyrave dhe arritjen e objektivave që ka caktuar Asambleja e Përgjithshme dhe përgatit për këto rje raport të hollesishem të cilin j'a paraqet Asamblesë së Përgjithshme të paktën një herë në vit ose edhe me shpesht kur kjo i kërkohet;
- f) Kujdeset përmajtjen e regullit të dokumentacionit finanziar dhe Bilancit. Në mbledhjen vjetore të Asamblesë së Përgjithshme paraqet një raport përfundimtar finanziar;
- g) Harton projekte të reja lidhur me aktivitetin e Shoqatës dhe ja paraqet përmiratim Asamblesë së Përgjithshme;
- h) Kryen të gjitha llojet e transaksioneve me perjashtim të atyre që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme dhe që janë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme apo që i janë vendosur kufizime sipas Statutit dhe vendimit të Asamblesë;
- i) Lidh dhe nënshkruan kontrata dhe marrëveshje me personat e tretë në emër të Shoqatës, në përputhje me ligjin, Statutin dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- j) Përfaqëson Shoqatën ne proceset gjyqësore kur është palë në gjykim;
- k) Rekruton dhe lagon punonjësit e administratës së Shoqatës;
- l) Propozon ndryshime në Statutin dhe Aktin e Themelimit të Shoqatës;
- m) Nxjerr urdhëra përmiratim së përditëshme në përputhje me rregulloret e brendshme, te miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- n) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Statuti dhe ligji.

12.2 Presidenti mund të delegojë një apo disa prej kompetencave të tij tek Sekretari i Përgjithshem në mënyrën e parashikuar në ligj.

12.3 Sekretari i Pergjithshem emerohet dhe shkarkohet nga Presidenti dhe ka një mandat 5 vjeçar me te drejte rizgjedhjeje. Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes për mbalevajtien administrative te shoqates, për mbajtjen e procesverbaleve te mbledhjeve te Asambles se Pergjithshme dhe akrimin e cdo dokumentacioni te shoqates. Sekretar i parë i shoqates do te jetë z.Alpin Galo.

KREU IV PROCEDURA TË VEÇANTA

NENI 13 RREGULLA PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË STATUTIT, AKTIT TË THEMELIMIT DHE RREGULLOREVE TË BRENDËSHME.

- 13.1 Të drejtën përmiratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit e ka vetëm Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Të drejtën përmiratimin e Statutit ose ne Aktin e Themelimit e kanë anëtarët e Asamblesë dhe Presidenti.
- 13.3 Propozimet përmiratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit, së bashku me argumentet përkatëse, i paraqiten me shkrim Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.4 Vendimi përmiratimin e Statutit, Aktit të Themelimit dhe Rregulloreve të brendëshme meren me shumicën e të gjithë anëtarëve të Shoqatës.

KREU V
VEPRIMTARIA FINANCIARE

NENI 14
VEPRIMTARIA EKONOMIKE

- 14.1 Shoqata për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tij, ka të drejte të kryejë veprimtari ekonomike. Të gjitha fitimet e realizuara do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit dhe të objektit të veprimtarisë së Shoqatës.

NENI 15
BURIMET E TË ARDHURAVE DHE MËNYRA E ADMINISTRIMIT

- 15.1 Burimet e te ardhurave do të sigurohen nga:
- a) Kuotat e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme që do të derdhin themeluesi dhe anëtarët e Shoqatës;
 - b) Ndihamat edhe të dhuratat e organizatave të tjera joftimprurëse, vendase ose të huaja;
 - c) Ndihamat nga personat juridik, fizik dhe individët;
 - d) Nga donacionet dhe grantet e ofruara nga subjektet private ose publike, organizatat ndërkombëtare etj;
 - e) Veprimtaria ekonomike që Shoqata mund të kryejë.
- 15.2 Të gjitha të ardhurat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Shoqatës do të administrohen në përbushje të qëllimit dhe funksionit të Shoqatës dhe në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Shitia apo blegra e pasurive të paluajtshme mund të kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shitia apo disponimi i aktiveve/pasurive të luajtshme të Shoqatës me vlerë më të lartë se 10% e aseteve të saj të rezultuara nga pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara, kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 16
MBAJTJA DHE MIRATIMI I BILANCIT

- 16.1 Librat finanziar të Shoqatës myllen në fund të çdo viti finanziar. Në bazë të tyre përpilohet bilanci vjetor finanziar si dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin pasardhës finanziar. Brenda tre muajve të përfundimit të vitit finanziar, bilanci vjetor dhe buxheti i të ardhurave dhe shpenzimeve duhet t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

KREU VI
PËRGJEGJËSIA

NENI 17
PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE DHE PUNONJËSVE

- 17.1 Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, si dhe punonjësit e Shoqatës nuk përgjigjen për detyrimet e saj ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, i kanë shkaktuar dëm të tretëve.


KREU VII
RIORGANIZIMI DHE NDËRPREJRJA E VEPRIMTARISË
NENI 18
TRANSFORMIMI, BASHKIMI

- 18.1 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqata mund të bashkohet, ndahet ose të transferohet në një organizatë tjeter jofitmprurëse. Vendimi merret në përputhje me regullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Statut.

NENI 19
SHPËRNDARJA, LIKUJDIMI, ÇREGJISTRIMI

- 19.1 Shpërndarja e Shoqatës bëhet në rastet e parashikuara në ligj. Shoqata mund të shpërndahet me iniciativën e vet ose me vendim të Gjykatës. Shpërndarja me iniciativën e vet Shoqatës miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.2 Kur Shoqata shpërndahet me iniciativën e vet Asambleja e Përgjithshme zgjedh një apo më shumë likuiditor, i cili ndiek procedurat e likujdimit dhe pajiset me kompetencat që i njeh ligji.
- 19.3 Në asnjë rast nuk lejohet shpërndarje ose disponimi i pasurive që rezultojnë në momentin e likujdimit në favor të anëtarëve ose personave të tjerë që janë subjekte të Statutit ose të Akitit të Themelimit të organizatës ose të afërmave të tyre. Në rastet kur Shoqata ka përfituar përjashtim nga taksat apo lehtësira fiskale, donacione nga publiku ose grante shtetërore, çdo pasuri e mbetur pas pagimit të detyrimeve i shpërndahet organizatave të tjera jofitimprurëse që ndjekin qëllime të njëjtë ose të ngjashme me Shoqatën.
- 19.4 Kur shpërndarja është vendosur nga vet Shoqata, Asambleja e Përgjithshme miraton raportin përfundimtar të likuiditorit dhe kërkon nga Gjykata çregjistrimin e Shoqatës.



- 20.1. Ky statut hyn ne fuqi diten e regjistrimit te Shoqates ne Gjykaten e Rrethit Gjyqsor Tirane, dite ne te cilin Shoqata fiton personalitet juridik.
- 20.2. Cdo mosmareveshje qe mund te lind ne lidhje me interpretimin apo zbatimin e ketij Statuti, organet drejtuese do te perpiqen ta zgjidhin me mirekuptim dhe negociata ndermjet paleve. Nese kjo gje nuk arrihet me mirekuptim, atehere, kompetente per zgjidhjen e mosmareveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 20.3. Per gjithcka qe nuk eshte parashikuar ne kete Statut palet do ti referohen legjislacionit perkates ne fuqi.

THEMELUESIT

1. Arjan Pano

2. Lorenc Kociu

3. Elvira Barka

4. Gezim Sala

5. Bektash Mema

6. Gezim Rredhi

7. Jani Dine

8. Aleksander Boboli

9. Klara Dudumi